



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 26.

Prishtinë, më 7.12.2015 në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Kikaj, Milka Vuletić, Sasha Milosavljević, Slavko Simić, Çerim Bajrami, Danush Ademi dhe Veton Berisha .

Munguan: Agim Çeku, Mufera Sinik, Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : Ardiana Gashi, përfaqësues nga OSBE-ja, Adelinë Sabiti-Kosova Pres, Sinisa Kostic-RTK-2, Artan Murati nga KAAD, Arlinda Bajrami nga Instituti GAB, Zijush Ahmeti -konsulltant i Sekretariatit të KKK dhe Celal Iliaz, nga Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma, koordinatorë dhe Drita Çarkaxhiu, zyrtarë e lartë ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua, ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 10.11/ dhe 24.11.2015;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja, propozoj të heqet pika e pestë e rendit të ditës, pasi ende nuk e kemi marr raportin me amendamente në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, nga Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa. Kjo pikë do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Kryesuesja- propozoi që rendi i ditës të plotësohet edhe me një pikë, Projektligji 05/L-052 Energjin Termike.

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës, me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.11.2015 dhe 24.11.2015;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 10.11.2015 dhe 24.11.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e Komisioni të deklarohen, nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandim, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Meqë nuk pati vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet, nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Meqë nuk pati vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjin Termike, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillime Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-052 për Energjin Termike dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet, nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Meqë nuk pati vërejtje në Projektligj dhe pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-052 për Energjin Termike dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme.

Veton Berisha- është i interesuar të informohet lidhur me ftesën e ministrit z. Mahir Yagcilar në mbledhje të komisionit, e cila ftesë është përsëritur disa her dhe deri më sot nuk kemi marrë përgjigjeje për mos pjesëmarrjen e tij në takim.

Ai propozoi që të ri-përsëritet ftesa për ministrin z. Mahir Yagcilar, gjithashtu të ftohet edhe sekretari i përgjithshëm z, Fitim Sadiku, që të raportojnë për çështjen e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht neni 11. Në fazën e fundit, GP do të vizitojë Kuvendin Komunal të Pejës.

Kryesuesja, e njoftoi komisionin, se sot kemi marr informatë zyrtare nga ministri z. Yagcilar se këtë javë është i gatshëm ti përgjigjet ftesës së komisionit.

Në kuadër të diskutimit, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxorri këtë :

Përfundim

Autorizohet stafi mbështetës i komisionit, ti bën thirrje ministrit z. Mahir Yagcilar dhe sekretarit të përgjithshëm Fitim Sadiku, për pjesëmarrje në takim të komisionit, e cili do të mbahet me datën 8.12.2015, në ora 11:00, me qëllim të raportimit lidhur me zbatueshmërin e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht neni 11.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Zhivković